



Datë: 26.01.2026
Numër Protokolli: 410/2026

A.nr.2038/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi, dhe, Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2038/2025, të datës 17.12.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.M, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.2038/2025, të datës 17.12.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.M.

A r s y e t i m

Ankuesi, A.M (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 17.12.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 17.12.2025 nën shenjën A.nr.2038/2025, kundër vendimit me numër protokolli 2115/2025 të datës 24.10.2025 të Inspektoratit Qendror të Punës/MFPT përmes të cilit është zbatuar vendimi me numër A.nr.1515/2025 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me anulimin e konkursin me numër Reference RN00017338, i shpallur me date 21.02.2025 për pozitën e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se Inspektorati Qendror i Punës/MFPT, më datë 21.03.2025, ka njoftuar kandidatët për aplikim lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017338, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë, numri i kërkuar sipas konkursit 4, i hapur për aplikim nga data 22.03.2025 deri më datën 20.04.2025.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës/MFPT më datë 11.07.2025 ka shpallur listën përfundimtare të vlerësimit ku sipas saj rezulton se si kandidat fitues i renditur i dyti sipas listës me 85.2 pike ishte ankuesi A.M.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1515/2025 të datës 01.10.2025, dhe për pasojë është anuluar konkursi me Nr. Reference: RN00017338 për grupin e administrimit të përgjithshëm, pozita Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë, i shpallur nga Inspektorati Qendror i Punës/MFPT, dhe të gjitha veprimet që janë ndërmarr si rezultat i këtij procesi.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.1515/2025 të datës 01.10.2025, dhe për pasojë është anuluar Konkursi me Referencë: RN00017338 për grupin e administrimit të përgjithshëm, pozita Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Pune, i shpallur nga Inspektorati Qendror i Punës/MFPT, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.17.12.2025/2025, të datës 17.12.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.2038/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.M;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.